



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 307/129
Data. 11-04-24

Prishtinë, 02 prill 2024

Kodi i ZRRE-së: V_1926_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenit 47, Nenit 48 dhe 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 37 dhe Nenit 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën ZRRE/Nr.15/2017 për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Metodologjinë për Strukturën Tarifore sipas Nenit 20 të Rregullës ZRRE/Nr. 15/2017 për të Hyrat e FSHU;
- Vendimin V_1924_2024 të datës 22 mars 2024 për aprovimin e Të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbim Universal (FSHU); dhe
- Propozimin e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU), për Tarifat e Furnizuesit me Shërbim Universal, të dërguar më datë 28 mars 2024 në ZRRE.

në seancën e mbajtur më 2 prill 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - Tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të mblidhen nga data 1 prill 2024 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
- II. Tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të zbatohet nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), janë paraqitur në tabelën e mëposhtme të këtij vendimi:

Tabela: Tarifat me pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë	Tarifa
1	35 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		12.52
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6.55
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.51
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.54
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.75		
2	10 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		5.17
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.65
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.41
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.13
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.75		
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.88
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.33
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.49
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.56
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.75		
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.33
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	9.88
			€/kWh	Tarifë e Lartë	11.99
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Ulët	5.94
5	0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.00
		0-800kWh (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.79
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.34
		>800kWh (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	13.29
€/kWh	Tarifë e Ulët		6.27		
6	0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.00
		0-800 (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e vetme	6.13
		>800 (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e vetme	10.67
7	0.4kV (familjarë pa matës)	Konsumi i vlerësuar:			
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.00
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë mesatare	7.79
8	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.59
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	10.34

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars
 Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator
 Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me $\cos(\Phi) < 0.95$

III. Ky vendim do të zbatohet nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), nga data 1 prill 2024 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM


- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 12 dhjetor 2023 ka iniciuar procesin: Azhurnimet Vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për Operatorët e Rregulluar, duke përfshirë edhe Furnizuesin me Shërbim Universal.
- ZRRE sipas njoftimit të saj ka vlerësuar se ky proces i Azhurnimeve Vjetore të Të Hyrave dhe Tarifave për vitin relevant tarifor 2024 ka për qëllim të vendosë Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të të Licencuarit Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU), për periudhën 1 prill 2024 deri më 31 mars 2025.


- ZRRE me datë 22 janar 2024 ka pranuar aplikacionin nga Furnizuesi me Shërbim Universal për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2024.
 - ZRRE më datë 6 shkurt 2024 ka publikuar Raportin Konsultativ-Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU), viti relevant tarifor 2024, ku i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.
 - ZRRE më datë 21 shkurt 2024 ka pranuar komentet nga FSHU dhe palët e interesit lidhur me vlerësimin fillestar të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU).
 - Raporti Përfundimtar i Shqyrtimit të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU, përfshinë edhe të dhënat e përditësuara nga FSHU. ZRRE në vlerësimin përfundimtar ka marrë në konsideratë përditësimet e bëra dhe çështjet e ngritura nga të gjitha palët e interesit në procesin e konsultimit publik.
 - ZRRE më 22 mars 2024 me anë të vendimit V_1924_2024 ka aprovuar Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU) për vitin relevant tarifor 2024.
 - ZRRE më datë 28 mars 2024 nga FSHU ka pranuar propozimin për tarifën e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU).
 - Tarifën e propozuar nga FSHU janë kalkuluar në pajtueshmëri me Metodologjinë për Strukturën Tarifore sipas Nenit 20 të Rregullës ZRRE/Nr. 15/2017 për të hyrat e FSHU. Propozimi i FSHU për tarifën e FSHU-së është i bazuar në vendimin e ZRRE-së për Të Hyrat e Lejuara Maksimale V_1924_2024 të datës 22 mars 2024.
 - Tarifën e propozuar nga FSHU, reflektojnë kostot e shërbimit të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal.
 - Tarifën me pakicë për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal të përcaktuara nga ZRRE reflektojnë kostot e përgjithshme të furnizimit të konsumatorëve me të drejtë të Furnizimit të Shërbimit Universal, ku përfshihen kostot e energjisë elektrike me shumicë, kostot e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes dhe kostot direkte të FSHU-së.
 - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të propozimit për tarifën e Furnizuesit me Shërbim Universal, ka vlerësuar se kërkesa është e bazuar në Vendimin V_1924_2024 të datës 22 mars 2024 për Të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adnan Prenqi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO,
- KEDS,
- KOSTT dhe
- Arkivit të ZRRE-së.